



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E STANDARDEVE TË FLUTURIMIT

Nr. ___prot. 2541 / 2

Tiranë, më 25.10.2024

VENDIM

Nr. 113, datë 25.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E DHËNIES SË PËRJASHTIMIT**

Në zbatim të Ligjit nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, Urdhrin e Ministrit Nr. 80, datë 30.06.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore" si dhe Urdhër Nr. 78/2024 Për miratimin e Rregullores “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, në vijim të kërkesës Nr. Prot. 2571, datë 25.10.2024 të Operatorit Ajror Air Albania Sh.p.k, Autoriteti i Aviacionit Civil analizoi rrethanat (*sipas ACAA-DLS-EXMP-101 dhe ACAA-DLS-EXMP-102*) dhe:

Nisur nga sa më sipër,

V E N D O S A

1. Dhënien e përjashtimit për transportin e artikullit UN 1133 Adhesives, nga operatori Air Albania.
2. Ky përjashtim zbatohet për fluturimet IST-TIA, përgjatë 72 orëve nga lëshimi i këtij përjashtimi.
3. Ky përjashtim është subjekt i kushteve të mëposhtme:
 - Të informohet pa vonësë Autoriteti i Aviacionit Civil për skedulimin e transportit si dhe kryerjen e tij dhe cdo detaj të fluturimit që lidhet me këtë përjashtim.
 - Të kryhet para fluturimit një briefing I vecantë për ekuipazhin si dhe të përcillet evidencë në AAC pas përfundimit të transportit.
 - Operatori ajror Air Albania të marrë masa për respektimin e të gjithë kërkesave të Urdhër Nr. 78/2024 Për miratimin e Rregullores “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, lidhur me paketimin, ndarjen, vendosjen, ngarkimit e shkarkimit të mallit.

- Pas përfundimit të transportit, të përcillet në AAC e gjithë paketa e fluturimit e plotësuar nga ekuipazhi.

4. Ky përjashtim është në fuqi deri në datë 27.10.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

